



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2024:082793  
Datë: 29.05.2024  
Numri i dokumentit: 05752529

PML.nr.318/2024

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët Afrim Shala, kryetar i kolegjit, Rasim Rasimi dhe Mejreme Memaj, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Sherif Krasniqi, procesmbajtës në çështjen penale ndaj të pandehurit Sh. A., për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale “*Vrasje e rëndë në tentativë*”, nga neni 173, paragrafi 1 nën-paragrafët 1.5 dhe 1.11 lidhur me nenin 28 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) dhe veprën penale “*Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve*” nga neni 366, paragrafi 1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit, të pandehurit e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë – Departamenti për Krime të Rënda, 2024:082793 të datës 04.05.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës- Departamenti për Krime të Rënda, PN1. nr.425/24 të datës 13.05.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 27.05.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit Sh. A., e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë – Departamenti për Krime të Rënda, 2024:082793 të datës 04.05.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës- Departamenti për Krime të Rënda, PN1. nr.425/24 të datës 13.05.2024.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Gjakovë – Departamenti për Krime të Rënda, me aktvendimin 2024:082793 të datës 04.05.2024, të pandehurit Sh. A., për shkak të dyshimit të bazuar se ka

kryer veprën penale “*Vrasje e rëndë në tentativë*”, nga neni 173, paragrafi 1 nën-paragrafët 1.5 dhe 1.11 lidhur me nenin 28 të KPRK-së dhe veprën penale “*Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve*” nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së, i ka caktuar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 1 (një) muaji, ashtu që sipas këtij aktvendimi, paraburgimi të pandehurit i është llogaritur nga data 03.05.2024 e deri me datën 02.06.2024. Të pandehurit paraburgimi i është caktuar konform dispozitës së nenit 184, paragrafi 1 nën-paragrafi 1.1 e 1.2 pikat: 1.2.1 dhe 1.2.3. të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, PN1.nr.425/2024 të datës 13.05.2024, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të pandehurit dhe ka vërtetuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit Sh. A., avokati Meshari Selimaj nga Gj., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 2 pika 2.7, nenit 432, pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 nenit 415, paragrafi 1 pikat 1.1 dhe 1.2, lidhur me paragrafin 1 nën-paragrafi 1.2 pika 1.2.3 të KPP-së dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta miratoj si të bazuar kërkesën, ashtu që aktvendimet e atakuara me kërkesë të anulohen dhe çështja të kthehet në gjykatën e shkallës së parë në rivendosje, apo t'i ndryshoj aktvendimet e njëjta ashtu që të pandehurit t'i zëvendësohet masa e paraburgimit me masën e arrestit shtëpiak, apo që ndaj të pandehurit të caktohet masa e dorëzimit në shumë prej 50.000 euro, apo cilën do shumë tjetër që e parasheh gjykata.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.III.nr.138/24 e datës 22.05.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të pandehur të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës e në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të KPP-së, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

- kërkesa nuk është e bazuar.

Në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të pandehurit theksohet se gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë, janë përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, pasi që të njëjtat nuk kanë bërë përkrahimin e provave, respektivisht nuk kanë arsyetuar bazat ligjore të rrezikut e ikjes, rrezikut të ndikimit dhe rrezikut të përsëritjes së veprës penale konform dispozitës së nenit 184, paragrafi 1 nën-paragrafi 1.1 dhe 1.2, pikat: 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 të KPP-së.

Mbrojtja e pandehurit në kërkesë thekson po ashtu sipas bindjes së tij se nuk qëndron konstatimi i gjykatave në vendimet e atakuara për ekzistimin e dyshimit të bazuar se i pandehuri ka krye veprën penale që i vihet në barrë, sepse rasti ka ndodhur me datë 10.03.2024, ka qenë krejt i atëçastshëm, nuk i ka paraprirë ndonjë konflikti të më hershëm, e as që ka pasur ndonjë motiv për të kryer vepër penale.

Tutje theksohet se nuk qëndron konstatimi i gjykatës për caktimin e paraburgimit nga rreziku se i pandehuri mund të arratiset nëse ndodhet duke u mbrojtur në liri, pasi që i njëjti që nga momenti që dyshohet se ka kryer veprën penale ka qenë i pa arritshëm për organet e ndjekjes, si dhe arsyet e dhëna lidhur me dënueshmërinë e veprës penale, për faktin se nuk ka logjikë apo kuptim që një person si në rastin konkret i cili është paraqitur para organeve të drejtësisë të thuhet se mund të arratiset dhe të jetë i pa arritshëm për organet e ndjekjes. I pandehuri në fjalë, është larguar për të mos u lajmëruar për disa javë, nga frika e reagimit të babait të tij, nga frika e ballafaqimit me bashkëshorten e tij, e në veçanti nga frika e hakmarrjes nga pala e dëmtuar ndaj tij, e që kjo vërtetohet me faktin se pas arritjes së pajtimit në mes familjeve të përfshira në këtë rast, rezulton edhe paraqitja vullnetare e të pandehurit para organeve të drejtësisë.

Po ashtu theksohet në kërkesë se caktimi i paraburgimit nuk është i arsyetuar as për bazën ligjore të rrezikut të ndikimit në rrjedhën e procedurës penale duke ndikuar në dëshmitar dhe procesin e hetimeve në përgjithësi, për faktin se masa e paraburgimit nuk është masë e vetme e sigurimit të prezencës së të pandehurit në procedurë, ngase për eliminimin e çfarëdo frike në këtë drejtim, masa e arrestit shtëpiak është masë e duhur dhe proporcionale për sigurimin e të pandehurit në procedurë.

Në kërkesë gjithashtu theksohet se gjykata në asnjë formë dhe mënyrë nuk ka arritur që përmes arsyeve të artikuleshme të vërtetoj ekzistimin mbi rrezikun që nëse i pandehuri lihet në liri mund të përsërisë apo të kryej ndonjë vepër tjetër penale, pasi që siç shihet edhe në aktin noterial të pajtimit të gjitha palëve të përfshira në rast, të njëjtat zotohen se do të kenë raporte njerëzore dhe miqësore me njëra tjetrën dhe se zgjatja e dorës së pajtimit u bë me vullnet, prandaj as rreziku i përsëritjes tash më nuk ekziston.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mësipërme ankimore janë të pabazuara, ngase si gjykata e shkallës së parë po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë kanë dhënë arsye të mjaftueshme për bazat ligjore të caktimit të paraburgimit. Nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, rezulton dyshimi i bazuar se i pandehuri është kryerës i veprave penale për të cilat dyshohet, me çka është plotësuar kushti ligjore nga neni 184, paragrafi 1 nën-paragrafi 1.1 të KPP, për caktimin e paraburgimit.

Po ashtu, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, qëndron baza ligjore për caktimin e paraburgimit ndaj të pandehurit Sh. A., sipas dispozitës së nenit 184 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2 pika 1.2.1 të KPP-së, duke pasur parasysh peshën e veprave penale dhe lartësinë e dënimit, ku është paraparë dënimi jo më pakë se 10 vite burgim nëse shpallet fajtor, ekziston rreziku real se me lënien e të pandehurit në liri i njëjti mund të arratiset për shkak se nga koha kur dyshohet se është kryer vepra penale me datë 10.03.2024, ka qenë i pa arritshëm nga organet e ndjekjes deri më datë 03.05.2024 kur është vet dorëzuar në polici.

Po ashtu, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, qëndron baza ligjore për caktimin e paraburgimit ndaj të pandehurit Sh. A., sipas dispozitës së nenit 184 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2 pika 1.2.2 e KPP-së, duke pasur parasysh faktin se procedura në këtë çështje penale është në fazën e

hetimeve dhe se prokuroria është në pritje të raportit të ekspertimit nga AKF-ja. Tutje duke pasur parasysh dyshimin e bazuar se i pandehuri Jakup e ka ndihmuar të pandehurin Sh., duke ia dërguar armën me të cilën dyshohet se është kryer vepra penale dhe të njëjtit lehtë mund të koordinohen rreth deklarimit të tyre për veprat për të cilat po hetohen, meqenëse i pandehuri ende nuk është deklaruar lidhur me çështjen, ashtu që me qëndrimin e të pandehurit në liri, ka arsye për të besuar se i pandehuri do të pengoj rrjedhën e procedurës penale duke ndikuar në dëshmitar dhe procesin e hetimeve në përgjithësi.

Gjithashtu, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës qëndron edhe baza ligjore për caktimin e paraburgimit ndaj të pandehurit Sh. A., nga neni nenit 184 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2 pika 1.2.3 e KPP-së, duke pasur parasysh peshën e veprës penale, mënyrën dhe rrethanat në të cilat dyshohet se janë kryer veprat penale, ashtu që i pandehuri me gjakftohtësi ditën kritike del nga lokali “Republika”, merr armën nga i pandehuri J. M., kthehet në lokal dhe në prezencë të më shumë se 200 mysafirëve të cilët ndodheshin në lokal, shtën me armë disa herë në drejtim të dëmtuarit D., dhe J. S., me çrast i godet të njëjtit duke iu shkaktuar plagë-lëndime të rënda trupore, si dhe të dëmtuarin F. Zh., e që ndaj tre të dëmtuarve lëndime këto të shkaktuara nga arma e zjarrit dhe po ashtu rrezikon jetën e të pranishmëve të tjerë në lokal dhe rrethanat tjera të ngjarjes, tregojnë rrezikun se nëse i pandehuri lihet në liri mund të përsërisë apo të përfundoj veprën e ngelur në tentativë.

Andaj, nga arsyet e mësipërme, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e as ligjit penal sepse si gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë vlerësimin dhe arsyetimin e duhur, si dhe në bazë të vlerësimit të tillë kanë nxjerrë aktvendimet duke dhënë edhe arsyet të mjaftueshme, ndërsa masat tjera alternative nga neni 171 i KPP-së, janë të pamjaftueshme për sigurimin e prezencës së të pandehurit në procedurë dhe sigurimin e rrjedhës normale të procedurës penale.

Nga sa u parashtrua më lartë dhe në kuptim të nenit 437 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.318/2024, më datë 27.05.2024

Bashkëpunëtori profesional,  
Sherif Krasniqi

Kryetar i kolegjit,  
Afrim Shala